

**Tryezë e rrumbullakët mbi "Mjetet efektive për mosekzekutimin apo ekzekutimin
e vonuar të vendimeve gjyqësore vendase"**

Konkluzionet e tryezës së rrumbullakët të mbajtur në Këshillin e Evropës

Strasbourg 15 – 16 Mars 2010

Duke pasur parasysh numrin vazhdimisht në rritje të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që zbulojnë probleme sistematike për shkak të mosekzekutimit ose ekzekutimit të vonuar të vendimeve gjyqësore vendase, si kundër enteve publike, duke përfshirë edhe vetë shteti, ashtu edhe individëve;

Duke kujtuar se zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore është thelbësor për sundimin e ligjit që Shtetet palë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë marrë përsipër të garantojnë, në veçanti nëpërmjet nenit 6, paragrafi 1, dhe të drejtës për gjykim të drejtë;

Duke kujtuar se të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkon që shtetet të marrin kryesisht të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që autoritetet kombëtare të ëzbatojnë në menyrë të shpejtë vendimet e brendshme gjyqësore dhe se kompleksiteti i zbatimit ose mungesa e burimeve buxhetore ose të tjera nuk mund të justifikojë mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar.

Duke kujtuar në këtë kontekst përfundimet e arritura në dy tryeza të rrumbullakëta të organizuara më parë rreth temës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore duke adresuar në veçanti çështjet lidhur me organizimin e procedurave shtetërore buxhetore dhe të shërbimit të përmbarimit 1;

Duke kujtuar në kontekstin e tanishëm kërkesat në lidhje me sigurimin e mjeteve efektive juridike vendase në përputhje me nenin 13 të Konventës, të cilat gjejnë shprehje të drejtpërdrejtë me parimin e subsidiaritetit sanksionuar në Nenin 1 të Konventës, sipas të cilit mbrojtja e të drejtave të njeriut përgjegjësi e parë dhe kryesore e sistemit të brendshëm juridik;

Duke kujtuar se neni 13 kërkon që shtetet të sigurojnë një rekurs të brendshëm për esuar substancën e një "ankesë të argumentuar" sipas Konventës dhe për të dhënë zgjidhje të përshtatshme, qoftë në formën e kompensimit, përshpejtimin dhe / ose forma të tjera të adresimit për çdo shkelje të gjetur;

Duke mbajtur gjithashtu në mendje Rekomandimet e Komitetit të Ministrave Rec (2004) 6 lidhur me përmirësimin e mjeteve të brendshme juridike dhe Rec (2010) 3 mbi mjetet juridike efektive për zgjatje të tepruar të procedurave dhe Guidave të praktikave të mira dhe raportet dhe udhëzimet e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) 2;

Duke kujtuar se gjetjet e shkeljeve nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendosin një detyrim ligjor për autoritetet shtetërore kompetente për të miratuar pa vonesë masa të përgjithshme për parandalimin e shkeljeve të ngjashme dhe që kanë nevojë për masa të tilla, duke përfshirë sigurimin e mjeteve efektive juridike vendase, për më tepër në rast të shkeljeve të përsëritura që zbulojnë problemeve strukturore;

Duke theksuar qendrimin e Komitetit të Ministrave se vendosja e mjeteve të brendshme juridike, megjithëse e rëndësishme, nuk i cliron nga shtetet nga detyrimi i tyre i përgjithshëm për të zgjidhur problemet strukturore që përbëjnë shkelje;

Duke vënë në dukje në veçanti rrezikun që problemet strukturore mund të gjenerojë një numër të madh të ankesave në pritje të miratimit të masave adekuate përmirësuese dhe rrezikun e ardhshëm të mbingarkimit të instancave kombëtare dhe / ose të organeve të Konventës;

Duke marrë në konsideratë shkëmbimin e përvojës ndërmjet Shteteve mbi problemet e hasura dhe masat konkrete të miratuara ose të parashikuara për të vënë në vend mjete juridike efektive për rastet e mos ekzekutimit dhe / ose procedurave tepër të gjata ekzekutimit të vendimeve të gjykatave vendore, në mënyrë të veçantë në përgjigje të vendimeve të Gjykatës Evropiane;

Duke theksuar përvojat e fituara nga përdorimi i procedurës së gjykimit pilot dhe detyrimet e vëna në vendimet përkatëse në lidhje me mjetet juridike efektive dhe, në veçanti, për sa i përket afateve të caktuara për futjen e mjeteve të tilla dhe zgjidhjen e rasteve të veçanta;

Duke vënë në dukje masa të tjera të ndryshme të miratuara në vende të ndryshme për të trajtuar pasojat e mos-ekzekutimit ose ekzekutimit ngadalshëm të vendimeve të gjykatave vendase, duke përfshirë ofrimin e kamatëvonesave të përshtatshme apo sistemet e indeksimit, futjen e një kompetencë të gjykatave apo organeve të veçanta gjyqësor për të vendosur sanksione sidomos monetare, mundësinë e konfiskimit edhe te pasurive shtetërore dhe monitorimin e përmirësuar të pajtueshmërisë së autoriteteve shtetërore "me vendimet gjyqësore nga prokurorët apo institucione të tjera ekuivalente;

Duke vënë në dukje reformat e rëndësishme e të vazhdueshme në një numër vendesh për të përmirësuar efikasitetin e shërbimeve përmbartimore dhe kontributin e vazhdueshëm të punës së CEPEJ;

Pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët:

Theksuan nevojën për çdo shtet për tu pajisur me instrumentet ligjore dhe resurset të cilat janë adekuate dhe të mjaftueshme për të siguruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase, duke përfshirë edhe ato kundër tij dhe enteve të tij;

Inkurajuan Shtetet që në pajtim me parimin e subsidiaritetit, të sigurojnë se ekzistojnë mjete që lejojnë parashikimin e nevojave të mundshme për futjen e mjeteve juridike të brendshme;

Theksuan rëndësinë për shtetet për të përfshirë çështjen e mjeteve juridike në planet e veprimit të hartuara pas vendimeve të Gjykatës Evropiane, në veçanti kur vendimet zbulojë probleme strukturore;

Vunë në dukje faktin se, ku problemet strukturore sistematike janë në themel të shkeljeve të konstatuara, futja e një mjeti, përsa e rëndësishme, nuk mund në vetvete të përbëjë një zgjidhje afatgjatë;

Nënvizuan nevojën, në rast të problemeve të mëdha strukturore, për të siguruar miratimin e strategjive të plota kombëtare, duke përfshirë edhe çështjen e mjeteve juridike, përfshirë të gjithë aktorët dhe vendimmarrësit në fjalë, në frymën e 'Rekomandimit Rec (2008) 2 të Komitetit të Ministrave për kapacitetet e brendshme efektive për ekzekutimin e shpejtë të vendimeve të Gjykatës Evropiane;

Njohën rëndësinë dhe nevojën e zhvillimit sa më shpejt të jetë e mundur, si në kuadrin e mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave të procesit të ekzekutimit dhe vendimit të Gjykatës Evropiane për procedurën pilot, ndërveprimin si në nivel kombëtar ashtu edhe Evropian për sa i përket strategjive të tilla gjithëpërfshirëse kombëtare,

Ranë dakord të vazhdojnë reflektime të vazhdueshme, duke përfshirë çështje të tilla si reforma e shërbimit të përmbartimit, me qëllim përshpejtimin dhe rritjen e efikasitetit të reformave në vendet e tyre respektive, si dhe të rifillojnë shqyrtimin e progresit të arritur në një formë të përshtatshme në rastin më të parë.

1 Konkluzionet e tryezave të rrumbullakta të 30-31 tetor 2006 mbi "Mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase kundër shtetit dhe njësive të tij në Federatën Ruse: problemet e mbetura dhe zgjidhjet e nevojshme", dhe të 21-22 qershor 2007 mbi "Mos-zbatimin e vendimeve të gjykatave vendase në shtetet anëtare: masa të përgjithshme në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane",

2 Shih në dokumentin CEPEJ (2009) 11REV Udhëzime për një zbatim më të mirë të rekomandimeve ekzistuese të Këshillit të Evropës mbi ekzekutimin, të miratuar nga CEPEJ në mbledhjen e 14-të plenare.